

VENDIM
Nr. 846, datë 7.12.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHETETËRORE TË POLICISË SË SHETITIT PËR MENAXHIMIN ELEKTRONIK TË GJOBAVE (E-GJOBA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të nenit 127, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Policisë së Shtetit për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba).
2. Institucioni administrues i Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba) është Policia e Shtetit.
3. Dhënësi i informacionit për këtë sistem është Drejtoria e Financës, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.
4. Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Gjobave ka për qëllim automatizimin e procesit të administrimit të gjobave si dhe përqendrimin e të dhënave të gjobave, për të gjitha njësitë e Policisë Rugore, duke i ofruar organeve përkatëse informacion të saktë dhe të shpejtë mbi:
 - a) gjendjen e gjobave të një mjeti (paguar/pa paguar), së bashku me të dhënat e mjetit;
 - b) historikun e mjetit dhe të veprimtarisë së plotë të përdoruesit;
 - c) raporte për gjobat, agjentin, vendimet e komisionit, mjetin, operatorët;
 - ç) statistika për gjendjen e gjobave, performancën e operatorit dhe pasqyrën e rezultateve;
 - d) plotësimin e një gjobe të re me të dhënat e punonjësit që vendos gjobën dhe të dhënat e shkelësit të dispozitave të Kodit Rugor.
5. Të dhënat parësore të Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Gjobave (E-gjoba) janë të dhënat e gjobës në të cilën vendoset numri serial i gjobës, koha e vendosjes së gjobës, vendndodhja, vlera e gjobës, shuma dhe arsyeja e vendosjes së gjobës.
6. Të dhënat dytësore janë të dhënat që merren nga:
 - a) DPSHTRR-ja, si: targa e mjetit, modeli i mjetit, shasia, pronari si dhe të dhënat për lejen e drejtimit dhe historikun e zotëruesit, të dhënat e plota të regjistrimit të mjetit dhe drejtuesit e mjeteve (pronar dhe përdorues);
 - b) sistemi i RMIS (Sistemi i Menaxhimit të Burimeve të Brendshme të Policisë së Shtetit), emër/mbiemër i punonjësit të Policisë që vendos gjobën, funksioni, struktura organizative ku ky punonjës bën pjesë, grada.
7. Baza e të dhënave E-gjoba ndërvepron me:
 - a) sistemin e DPSHTRR-së, ku merren të dhënat e mjeteve në bazë të targës (Targa, modeli, shasia, pronari etj.);
 - b) sistemin RMIS (Sistemi i Menaxhimit të Burimeve të Brendshme të Policisë së Shtetit), ku merren të dhënat e punonjësit të Policisë që vendos gjobën (emër, mbiemër, struktura organizative së cilës i përket).
8. Shtetasi ka nivel aksesit vetëm për konsultimin e informacioneve të vëna në dispozicion, nëpërmjet faqes së internetit të Policisë së Shtetit, www.asp.gov.al, (rubrika Shërbime/ Kontrolloni gjobat tuaja).
9. Për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, niveli i aksesit, përcaktohet në rregulloren e brendshme të bazës të të dhënave shtetërore të E-gjoba, e cila miratohet me urdhër të drejtorit të Policisë së Shtetit.

10. Sistemi E-gjoba ka 6 nivele përdoruesish:

- a) Niveli “Gjobë” i përdoruesit;
- b) Niveli “Raporte”;
- c) Niveli “Menaxhim”;
- ç) Niveli “Komision”;
- d) Niveli “Financë”;
- dh) Niveli “Supervizor”.

11. Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe përcaktohen në procedurat e punës, të cilat miratohen nga drejtori i Policisë së Shtetit për secilin punonjës.

12. Subjektet e interesuara për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjjobave (E-gjoba), janë, si më poshtë:

- a) Policia e Shtetit;
- b) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF);
- c) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR);
- ç) Autoriteti Kombëtar i Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- d) Institucionet financiare jobankare;
- dh) Bankat e nivelit të dytë.

Akresi i subjekteve të përcaktuara në këtë pikë, në Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjjobave, është i kufizuar, sipas legjislacionit që rregullon veprimtarinë e tyre dhe qëllimin e përpunimit.

13. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të Sistemit E-gjoba të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane dhe ndërkombëtare, në fushën e standardizimit, do të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i bazës të të dhënave shtetërore për Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Gjjobave (E-gjoba) përcaktohet në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës të të dhënave shtetërore, të miratuar nga drejtori i Policisë së Shtetit.

15. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama